Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**17.07.2023**	**27.07.2023**	**2023/0475**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.07.2023, OE "NNT BINI SH.P.K."- Podujevë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0475, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE "URBAN O.P & Amari GFC SH.P.K."- Mitrovicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i kanalizimeve sipas lot I deri ne III" me nr. të prokurimit: "VU644-23-2787-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E VUSHTRRISË.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë: 27.03.2023

Hapja e Tenderëve: 12.05.2023

Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 20.06.2023

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 1,879,591.89 €.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë NUK është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0475 i dt:10.07.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 par.2 (Qëllimi) i LPP-së nr.04/L-042; lidhur me parimet bazike nga neni 4.4 i RrUOPP;

Neni 7 par.1, 2 dhe 4 (Barazia në trajtim/Jo-diskriminimi) i LPP-së nr.04/L-042 lidhur me parimet bazike nga neni 4.4 i RrUOPP;

Neni 59 par. 2 dhe 4 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) i LPP-së nr.04/L-042, lidhur me nenin 40 dhe 41 pika 3 të RrUOPP;

Neni 60 par. 1 (Kriteret për dhënie të kontratës) 5. Neni 69 (Aftesia teknike dhe/ose profesionale)

Me datë: 20.06.2023 kemi pranuar Letrën Standarde për Tenderuesin e Pasukseshëm.
- Po në këtë datë ne kemi kërkuar qasje e dokumentacionin tenderit të OE të propozuar për dhënie. Qasja na është mundësuar me date me date 21.06.2023.
Në qasje ne kemi kërkuar qe te na jepet raporti i vlersimit nga ana e komisionit dhe komunikimet (sqarime) nese ka pasur po ashtu edhe kërkesat per sqarime.
- Neve nga ana e AK kemi pranuar raportin e vlersimit dhe sqarimet e kërkuara drejt O.E. propozuar per dhënie .
Gjatë analizës të dokumentacionit të dorëzuar të tenderit nga ana e OE të propozuar për kontratë ne kemi vërejtur se komisioni i vlerësimit pranë AK Komuna e Vushtrrisë ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-se dhe rregullave te UOPP-se.
Ne vijim po ju paraqesim ne mënyrë te detajuar faktet dhe argumentet te cilat AK nuk i ka respektuar me rastin e vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit te tenderëve.
Faktet dhe argumentet te cilat nuk i ka plotësuar G.O.E. i rekomanduar për kontrate:
Urban OP & Amari GFC SHPK
Me dt 03.07.2023 kemi pranuar vendim mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim te cilen po e bashkengjesim me poshte :

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: NNT " **Bini "sh.p.k.** – **Podujevë**, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën **03.07.2023,** merr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet si e pabazë** Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e eliminuar, të subjektit në procedurë: NNT " **Bini "sh.p.k.** – **Podujevë**, **në procedurën e prokurimit me titull: " Ndërtimi i kanalizimeve , sipas Lot. 1 deri Lot. 3" , Nr.i prokurimit: VU644 – 23 – 2787 – 5-1-1 e Nr. i brendshëm: VU644-23-020-511**
2. **Vërtetohet si i bazuar** Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. **20.06.2023**

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejmë A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që në Lotin 1 " Ndërtimi i kanalizimeve sipas Lot. 1 " ta rekomandoi për dhënie të kontratës: **Grupin e** OE.: " **Urban O.P.** "& " **Amari GFC** "sh.p.k. me seli në Mitrovicë, ndërsa, O.E.: **NNT " Bini** "sh.p.k. (në tekstin e mëtejmë Ankuesin) ta renditë në mesin e O.E. të pasuksesshëm, bazuar në procedurën e zbatuar.

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi letër për tenderuesin e eliminuar për Ankuesin janë dërguar për publikim në platformën elektronike më dt. **20.06.2023**, bazuar në dispozitat e nenit 42 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se, duke vendosur si në **Vendimin e dt. 20.06.2023**, A.K. ka shkelur dispozitat e LPP-së , konkretisht: nenin 1 – Qëllimi , nenin 7 – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, nenin 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve dhe nenin 60 paragrafi 1 – Kriteret për dhënie të kontratës dhe nenin 69 – Aftësia teknike dhe / ose profesionale.

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë , për arsye se:

1. Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, neni 7 ka pasur për qëllim trajtimin e barabartë, pa diskriminuar asnjë prej O.E. pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, Neni 33 paragrafi 1 (Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 59 (Ekzaminimi, vlerësimi dh krahasimi i tenderëve) lidhur me nenin 60 paragrafi 1 pika 1.1 **(tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët)** ka pasur për qëllim, që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të tenderëve, të vendosë për dhënie të kontratës O.E. me **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.** Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se **Vendimi i A.K. i dt. 20.06.2023** është marrë bazuar në kushtet , rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së, vendimi, sikurse ka vlerësuar A.K., është i mbështetur mbi baza ligjore e faktike, i pandikuar, që nuk diskriminon dhe që ka një transparencë të lartë të vendimmarrjes dhe po ashtu duke zbatuar kërkesat procedurale dhe qenësore të dispozitave të LPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues më tej vlerëson se të gjithë tenderët e tenderuesve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndërsa, i gjithë procesi ka qenë transparent, duke përfshirë këtu edhe të drejtën Ankuesit për të realizuar qasjen në dokumente të tenderit, konform nenit 10 dhe 11 të LPP-së.
3. Vendimi për ta rekomanduar për dhënie të kontratës : **OE.: " Urban O.P. "& " Amari GFC "sh.p.k. me seli në Mitrovicë** është marrë në mes tjerash edhe në zbatimin e nenit 59 të LPP-së, sepse një tender do të konsiderohet i përgjegjshëm dhe i pranueshëm vetëm nëse përmbushë kërkesat administrative, profesionale dhe minimalisht ato teknike dhe / ose profesionale të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.
4. Lidhur me pretendimin e Ankuesit se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka dorëzuar Certifikatën e TVSH-së , A.K. vlerëson këtë pretendim si të pasaktë sepse, sikurse është konstatuar padiskutueshëm, të dy anëtarët e Grupit të O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës kanë dorëzuar Certifikatën e TVSH-së duke i përmbushë kërkesat lidhur me Përshtatshmërinë Profesionale, sipas Nenit 7.1 lidhur me 7.2 të FTD-së , Kërkesat lidhur me Përshtatshmërinë Profesionale.
5. Pretendimi i Ankuesit se Grupi i O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka dorëzuar një Listë të projekteve sipas Aneksit 6 të Dosjes së tenderit, fillimisht sqarojmë se Aneksi 6 i Dosjes së Tenderit nuk përmban një kërkesë të tillë. Nga verifikimi i dëshmive të dorëzuara në Dosjen e Tenderit vërtetohet qartë se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës ka dorëzuar Listën e projekteve të përfunduara, dhe A.K. e ka vlerësuar si të rregullt pa ndonjë devijim të theksuar material marrë parasysh se O.E. bashkangjitur me Listën ka dorëzuar dhe Refrencën ose Raportin e Pranimit teknik të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues ku është ekzekutuar projekti dhe bazuar në faktin se dokumentet e dorëzuara pasqyrojnë dhe plotësojnë njëra tjetrën, Komisioni i vlerësimit i A.K. gjatë procesit të vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të dokumenteve nuk ka pasur ndonjë vërejtje, vështirësi apo paqartësi në vlerësimin e përmbushjes ose jo të kërkesave nga O.E. , të saktësuara në Dosjen e Tenderit, nenin 9.1 lidhur me 9.2 të FTD-së – Kërkesat lidhur me aftësitë teknike dhe / ose profesionale.
6. Lidhur me pretendimin e Ankuesit se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk i përmbushë kërkesat lidhur me posedimin e mekanizimit, respektivisht pajisjeve teknike në dispozicion për ekzekutimin e punimeve për të cilat ka tenderuar, A.K. konstaton se në Dosjen e Tenderit është dorëzuar e plotësuar dhe nënshkruar Lista sipas Aneksit 7 , ashtu sikurse është kërkuara në FTD, pika 4 dhe po ashtu bashkangjitur është dorëzuar dhe Deklarata me shkrim e nënshkruar dhe vulosur nga O.E për posedimin e pajisjeve të kërkuara – listuara si në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit, ndërsa dokumente apo dëshmi tjera plotësuese, sikurse pretendon Ankuesi, nuk janë kërkuar të dorëzohen. Andaj dhe ky pretendim ankimor i Ankuesit nuk qëndron sepse nuk është i bazuar dhe si i tillë është hedhur poshtë.
7. Lidhur me pretendimin ankimor të Ankuesit se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka pasur të drejtë të marrë pajisje me çera sipas ndonjë Marrëveshjeje pasi që , sikurse thekson Ankuesi, kjo mundësi nuk është e cekur në Dosjen e Tenderit dhe, bazuar në këtë O.e është i papërgjegjshëm, A.K. pasi vlerësoi këtë pretendim konstaton se pretendimi i Ankuesit është i pabazuar në dispozita ligjore. Sipas dispozitave të LPP-së O.E. i lejohet marrja me çera e pajisjeve teknike për ekzekutim të punimeve dhe A.K. nuk e ka ndaluar një mundësi të tillë.
8. Lidhur me pretendimin se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka dorëzuar Sigurinë e Tenderit, A.K. sqaron se një kërkesë e tillë nuk është saktësuar në nenin 13.1 të FTD-së pjesë e Dosjes së Tenderit, andaj dhe ky pretendim është hedhur poshtë si i pa saktë dhe jo i bazuar. Pretendimet tjera të Ankuesit , si mungesa e saktësimit të datës së përfundimit të projekteve në Listën e projekteve, sikurse ka vlerësuar A.K. paraqesin devijime të vogla, në kuadër të margjinave të lejuaa të LPP-së dhe të njejtat nuk paraqesin largim dhe kufizim thelbësorë nga Kërkesat e Dosjes së Tenderit për arsye se :
   - Nuk dallojnë esencialisht nga kushtet dhe dhe specifikimet e dosjes së tenderit;
   - Nuk fektojnë cilësinë ose ekzekutimin e kontratës;
   - Nuk kufizojnë të drejtat e A.K. dhe / ose obligimet e tenderuesit sipas kontratës dhe
   - Nuk shtrembëron konkurencën e tenderuesve, ofertimet e të cilëve janë në pajtueshmëri me rregullat e tenderit.
9. A.K. vlerëson se duke marrë këtë vendim ka pasur parasysh dhe mbrojtjen e parimit " VLERA PËR PARANË " , duke vlerësuar dhe respektuar fillimisht dispozitat ligjore lidhur me procesin e Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahasimit të tenderëve duke marrë për bazë dhe transparencën,

Trajtimin e barabartë të O.E. dhe jo-diskriminim në mes të O.E. duke përfunduar me zbatimin e parimit të " vlera për paranë " i cili në fakt është parim shumë i rëndësishëm për buxhetin e A.K. dhe të cilin sigurisht se A.K. e ka pasur në konsideratë.

10. Bazuar në të gjitha të cekurat si më lartë në këtë Vendim, A.K. vlerëson se pretendimet e Ankuesit janë të pabazuara, të pasakta dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. Përfundimisht, A.K. vlerëson se me rastin e marrjes së vendimit si ai i dt. 20.06.2023 për të përzgjedhur për rekomandim me dhënie të kontratës të Grupin e O.E.: " **Urban O.P. "& " Amari GFC "sh.p.k. me seli në Mitrovicë**, nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, me theks të veçantë neni 1 – Qëllimi, neni 7 – Barazia në trajtim/ Jo - diskriminimi sepse është rekomanduar O.E. me tender të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët ndërsa me asnjë provë nuk është vërtetuar se ndonjë O.E. është trajtuar Jo-barabar apo diskriminuese, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë në mes O.E., neni 51 – Njoftimi i kritereve të dhënies së kontratës dhe neni 59 parag.4 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K. përmes këtij Vendimi, janë të pabaza, jo të sakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë.

Nga sa u tha me lartë, e në pajtim me nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 të Rregullave për paraqitje të kërkesë për rishqyrtim, A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim Juridik :
Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur dispozitat e LPP-së apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni Ankesë pranë OSHP-së (Organit Shqyrtues për Prokurim Publik), në bazë të nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
K.R. nr. 020/2023 - datë 03/07/2023

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)

Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik

Albanez Tahiraj

Andaj në vështrim të gjendjes faktike dhe në vështrim të bazës ligjore me vendimin e kundërshtuar shklejet konsistojnë në faktet dhe rrethanat e cekura siç janë pasqyruar në objektin e pretendimeve dhe atë për arsyet si në vijim:

Pretendimi Nr. 1
Është kërkuar:
- a) Certifikata e TVSH-s.
Dëshmia e kërkuar:

a) Kopja e certifikatës së TVSH-së .
G.O.E. sipas dokumentacionit të dorëzuar nuk ka dorëzuar certifikatën e TVSH-së për partnerin e konzorciumit gjegjësisht për kompaninë AMARI GFC madje të njëjtën GOE nuk e ka dorëzuar pas kërkimit të sqarimeve nga ana e AK-së . Arsyeja e mosdorëzimit të certifikatës në fjalë është se OE Amari GFC nuk e ka poseduar atë certifikatë për të cilën OE ka aplikuar pas datës së hapjes së ofertave . Certifikata e TVSH për OE AMARI GFC nuk ka qenë në dosje as kur kemi marrur qasje në dokumente pranë AK por e njëjta na është dërguar më vonë në formë elektronike. Ky pretendim përbënë shkelje të dispozitave ligjore të LPP dhe RRUOP pasiqë AK ka shpallur fitues OE i cili në këtë rast nuk është i përgjegjshëm kurse kriter për dhënien e kontratës ka qenë OPERATORI I PËRGJEGJSHËM me çmimin më të ulët .

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E FINANCAVE – MINISTARSTVO ZA FINANSIJE – MINISTRY OF FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS – POREŠKA ADMINISTRACIJA KOSOVA – TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

ÇERTIFIKATË - DEKLARUES I TVSH

UVERENJE - OBVEZNIK ZA PDV

CERTIFICATE - VAT FILER

Numri Broj Number	330559809
Numri Fiscal Fiskalni Broj Fiscal Number	811906603
Emri i personit Ime osobe Person's Name	Amari GFC SH.P.K.
Adresa e Personit Adresa osobe Person's Address	n. ZHABAR I EPËRM MITROVICË KOSOVA
Data e Regjistrimit Datum Registracije Registration Date	05-06-2023
Data e Lëshimit Datum Izdavanja Date of Issuance	05-06-2023
Personi Përgjegjës Odgovorno Lice Responsible Person	

Kjo certifikatë është lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 05/L-037 per Tatimin mbi vlerën e shtuar.
Ovaj certifikat izdat je od Poreske Administracije Kosova, shodno Zakona Br. 05/L-037 O Porezu na Dodanu Vrednost.
This certificate is issued by the Tax Administration of Kosovo, based on the Law Nr. 05/L-037 on Value Added Tax.

VERSIONI - 6 - KORIGJUAR 03-05-2011

a) 1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, (ndërtim i ulet), në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej Loto 1. 600,000.00 euro Loto 2. 700,000.00 euro Loto 3. 800,000.00 euro

Në rast të Grupit të Op.Ek. lideri i grupit duhet të ketë jo më pak se 60% të vlerës së saktësuar si më lartë.:

Dëshmia e kërkuar:

a) Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.

Shënim Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 e me shume Lote, shuma më e lartë e kontratave që kërkohet për Lotet për të cilat konkurron duhet të përmbushet nga OE G.O.E. sipas dokumentacionit nuk e ka dorëzuar listën sipas kërkesës së AK-së pasiqë në listën e dorëzuar nga GOE i rekomanduar për kontratë , në shumicën e kontratave nuk figuron data e përfundimit siç është kërkuar nga ana e AK-së. Kjo përbënë shkelje sepse ANEKSI 6 është obligativ .

"URBAN" Q.P. Mitrovicë
r.n."Selanikë" pn nr.

Lista

e punëve te kontraktuara dhe te ekzekutuara ne tri vitet e fundit (2020,2021 dhe 2022) gjendja me 31.12.2022
(kontratat,raportet të prranimit teknik dhe referencat)

Nr.r.	Investitori	Emrat lanshëm	Data dhe nr.i kontratës	Vendqëndrimi	Vlera e punëve te kontruktuar	Punët e ekzekutuara	Vlera e punëve te kryera ne €
1.	Komuna Ujgjon	Adem Durjaj	023-657-104-503 k.e dt 28.02.2017- 28.08.2020	Komuna Ujgjonë	115.705,30	Mirëmbajtja e rrugëve te asfaltuara nga çelësi dhe fshatra te kom.se Ujgjonë	115.705,30
2.	Komuna Mitrovicë	Rushkiner Farati	642-19-1279-5-2-1 e dt.01.10.2019 (Nr qrc.)	Mitrovicë	427.921,40	Krijimi I kapitrrve gjykësorë dhe rekreative për fëmijët në Mitrovicë	427.921,40
3.	Hazeka Kom	Hashi Zejnullahu	Kontr. e datës 06.09.2020	Mitrovicë	145.095,00	Vazhdimësia ndërtimit ne implementimin e projektit "Zonimi - riparimi i gropave ne qytet "Kontrata 642-19-504-5-2-1	145.376,80
4.	K.Mitrovicë	Rushkiner Farati	642-20-999-2-1-5 e dt.07.04.2020	Mitrovicë	57.095,50	Lyrja fabrike dhe mirëmbajtja dimenore e rrugëve; Kontrata nr.642-20-999-2-1-5	57.095,50
5.	"KWE"shpk	Argjend Halili	Kontr.e dat. 06.04.2020	Prishtinë	35.550,60	Gërmimi i dendësisë te asfaltit dhe kulloni i rrugëve ne gjerësi e mapanëme te ulët / ka dëmtuar gjate punës ne proj. "Rehabilitation of the district heating network in Prishtina	35.228,41
6.	Antera Group	Valon Fejzullahu	K.e dt.10.05.2020	Mitrovicë	55.000,00	Ndërtimi i infrastrukturës- hapja e kanalave dhe vendosja e gypave të ndryshëm në shtresën e shkëmbit e mbushjes bazuare ne Mitrovicë	38.220,42
7.	"KWE" shpk	Argjend Halili	Kontr.e dat. 12.08.2020	Gjakovë	19.300,00	Rehabilitimi dhe hetimi i rrugëve ne gjerësi e mapanëme nga çelësi deri ne shkollën "Ismail Qemali" Gjakovë EPW/BoQ/ projekti: "Rehabilitation and extension of the sewerage network Gjakova EPW/BoQ/	19.398,30
8.	"ADA" shpk	Shkodran Jahiu	Kontr.e datës 19.06.2020	Prishtinë	11.000,00	Asfaltimi i dendësisë te asfaltit nga rruga e Prishtinës dhe kulloni jete ne gjerësi e mapanëme si dhe asfalt / shtresë te lëmjanë ne lëk. Vushtrri-Mitrovicë	10.041,39
9.	K.Mitrovicë	Rushkiner Farati	K. nr.642-20-1765-5-2-1 e dt.23.04.2020	Mitrovicë - Fushë	404.194,40	Ndërtimi i infrastrukturës ne "Lagjen e Re" Fushë	404.179,90
10.	"Prenar"shpk	Shaqir Mikullovci	Kontr. e datës 03.08.2020	Vushtrri	8.200,00	Ndërtimi i infrastrukturës rreth objektit afërsisë prenar "Innovach" dhe asfaltimi i plotësimit ne rr.sjellë objekt	8.077,40
11.	"Union"shpk	Shaqir Lajmoj	Kontr. e datës 27.08.2020	Vushtrri	37.880,00	Krijimi i infrastrukturës ne shtresë dhe asfaltimi i plotësimit ne rr.sjellë objekt ne Vushtrri	37.753,07
12.	"ABA J"shpk	Shkodran Jahiu	Kontr. nr.nëse 03.10.2020	Fushë Bazës	10.000,00	Vazhdimësia punës ne mënyrë e dëmtimeve te asfaltit dhe kulloni i rrugës ne gjerësi e mapanëme fsh.Fushë Bazës	10.020,52
13.	Tek-log shpk	Doner Dergjaci	28.10.2020	Deniva Mitrovicë-aj.	15.000,00	Asfaltimi i dendësisë te asfaltit nga disa rrugët:Gërbar,Llapllobardh,Tugjal,Terstenik, Objekt K.Mitrovicë-aj.dhe kulloni i tërë ne gjerësi e mapanëme	8.567,97

MUNGON DATA
E PËRFUNDIMIT

Remove Wate mark

14.	Artant Company Vushtrri	Naser Imeri	29.10.2020	Vushtrri	17.000,00	Furnizimi i infrastrukturës ne shërbim dhe mbushjen i pjesëve ndërtuese me Vushtrri	22.290,00
15.	"NIQER" "Xhemo Com"	Xhemaile Sejdija	Kontr.e datës 21.11.2020	Lipjan	6.400,00	Nënkontraktimi punës: Riparim-zëvënë i dërrmimeve (e mbëlli ka formë dërrmë) rajon rruge e komunës ne Lipjanë	6.400,00
16.	e.A.E-Dege Kosovë	Serjan Lleshi	K.r ik 09.03.2021	Banër Modë	23.391,60	Mbushjen i dërrmimeve të mbëlli nëpër rrugët e fës.Banër i Modë,F.Kosovë,Lakas dë,ad rrëll,e proj.rrugës Jerusalemi investimor(projekt 2020 Lot-1 PP PërfëlisëDistrict	23.391,60
17.	Tuk-ing shpk	Besim Berguti	K.r ik 10.04.2021	Prishtinë	36.000,00	Riparimi-mbushja i dërrmimeve të mbëlli nëpër disa rrugët të Prishtinës dhe lëshimi i gro të gjendjes e mëparshme –(mbëlumët) proj.Çamëria 3",Nëmuçë Dibrë mb.perfunu i rrjetit disa	36.000,00
18.	"Elvko"shpk	Agim Kaçi	03.07.2021	Prishtinë	5.500,00	Riparimi i dërrmimeve të mbëlli nëpër disa rrugët të Prishtinës dhe lëshimi gro të gjendjes e mëparshme	5.116,35
19.	K.Mitrovicë	Hashimet Farati	440-21-2021-521	Mitrovicë	164.175,51	Furnizimi i rrjetit të bujqësisë publike pëërgatit konë Ibër –Ndërtimi i shtigjeve të kishëzës dhe Parkut në Lagjën e Bosnës	153.185,54
20.	K.Vushtrri	Avdi Hoxaliaj	644-20-6395-521-	Vushtrri	297.675,29	Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale me Infrastrukturë	297.675,29
21.	"Prenc"shpk	Shaip Mikullovci	K.r ik.23.06.2021	Mitrovicë	135.837,80	Ndërtimi i Infrastrukturës dhë mbushjes i pllacës së objektit sfërës së Tunelit-it në Mitrovicë	135.837,80
22.	"Prenc"shpk	Shaip Mikullovci	K.r ik.02.08.2021	Deçan	20.880,80	Ndërtimi i Infrastrukturës dhë mbushjes i parkingut të objektit sfërës së "Internet-it"	19.351,94
23.	K.Mitrovicë	Hashimet Farati	K.r ik.04.08.2021	Mitrovicë	45.125,63	Ndërtimi i infrastrukturës ne "Lagjën e Re" Fushë-Asfalt lëmirësë par mori mënjëherë	45.125,63
24.	"AV-Jeton"	Bujar Zymberi	K.r ik.03.11.2021	Prishtinë	5.600,00	Riparimi i dëmtimeve të mbëlli në rrëll,e projektit "Disetet Heating System Prishtina Contract 2 Asphalt and Installation of DH pipes RAEEC 2016/7555 "	6.134,00
25.	"Prenc"shpk	Shaip Mikullovci	K.r ik.25.11.2021	F.Kosovë	21.000,00	Ndërtimi i Infrastrukturës dhë mbushjes i pllacës së objektit sfërës së Tunelit-it në F.Kosovë	22.670,10
26.	"Eling Group"	Kushtrim Nimaj	Kon.r ik.03.06.2022	Prishtinë	18.000,00	Riparimi,Zëvënë I dëmtimeve të mbëlli nëpër rrugët e Prishtinës – Lagjës "Kalabria"	17.472,00
27.	" Prenc "ZH.P.K	Ylber Kurtaj	Kon.r ik.28.07.222	Peja	1.296.589,66	Ndërtimi I infrastrukturës si objektit sfërës-magjistr të Tunelit-it në Asanëllas Rrëll Peë-Peja	790.359,42
	Vlera e përgjithshme e punëve të kontraktuara				3.555.794,31	*Vlera e përgjithshme e punëve të realizuara (të kryera)*	2.012.950,53

Më 31.12.2022
Mitrovicë

Furnizimi përfaqësi:
Ibish Çerani

Pretendimi Nr.3
Është kërkuar:
a) Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit dhe atë minimum a)2(dy) Eskevator-Bager me goma minimumi..9 ton
b) 1 (Një) Eskevator Bager zingjir. Minimumi 10 ton.
c) 2 (dy) Kamiona me aftësi bartëse minimum 10ton
d) 1(nje) Kamiona me aftësi bartëse minimum 6ton
dh) 1(nje) Rrafshues tereni greder
e) 1(nje) Ngjeshse e zhavorit
) 1(nje) Ngjeshse dheut
1 (nje) Makineri për shpime horizontale 1 (nje)Kamion Cistern për ujë minimum 6m3
Dëshmia e kërkuar:
a) Dëshmia 4. Lista për makanizimin dhe paisjet sipas Aneksit 7. e cila duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur dhe Një deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe evulosur me të cilen dëshmohet për makinerin dhe paisjet në dispozicion të tenderuesit që ekzekuton shërbimet.
G.O.E. ka ofruar listën e makinerisë sipas ANEKSIT 7 mirëpo tek pika c) 2 (dy) Kamiona

me aftësi bartëse minimum 10ton ,GOE i rekomanduar për kontratë ka ofruar tjetër makineri (jo atë që është kërkuar në DT) . Ndryshimi i kritereve përbënë ndryshim thelbësor andaj rekomandimi për dhënie të kontratës për GOE në fjalë të cilët janë të papërgjegjshëm përbënë shkelje të dispozitave të LPP dhe RRUOP.

b) Në FTD nuk ceket se lejohet marrëveshje për marrje të mjeteve me qira andaj ne si OE konsiderojmë se GOE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm pasiqë nuk e plotëson këtë kërkesë të AK-së meqenëse një pjesë të makinerisë e ka të marrura me qira.



Titulli : Naërtimi i kanalizimeve sipas Lot I deri në III

Aneksi 7. PAJISJET DHE MEKANIZMI I OBLIGUESHËM

Mekanizimi dhe pajisjet e paraqitura ne Kërkesat mbi mundësitë teknikodhe/ose profesionale
Operatorët Ekonomik, mundësojnë që në listë të shtojnë edhe mekanizim dhe pajisje treja shtesë si në aspektin e llojit sahtu edhe të sasisë.
Lista duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga operatori ekonomik.

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e Kërkuar	Sasia e ofruar	Të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes , lamiona nën, i targave, mekanizmi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim ,foto etj
1	a) Eskavator –bagar me goma min.9 t.	2	3	1.bager "Liebher"Tipi A-902 Ukrainë,ngjyra e verdhë-portokalli prodh.1997,nr.serik:3584072,gjendja e mirë 2.bager "Liebher" Tip: A-306,viti prodh.1999,nr.i shasisë:3740579,gjendja e mirë
2	b) Eskavator – bager në tërësi min.10 t.	1	2	Ekl. Me "Volvo": Tip: EC250 NLC Peshë: 22.400 kg - Viti i prodh. 2003, gjendja e mirë Eskavator "Liebher " Tip: R 924B HDSL Peshë : 24.000 kg Viti- 2005, gjendja e mirë
3	c) Kamiona me kapacitet minimum 10 m^3kipër	2	4	Kam "Man" kipper 27.463 Gvt – me tp.reg.02 -570 –AF, Vi i prodh.,1998, gjendja e mirë Kam."Man" me tp.reg.02-629-IE, Viti i prodh. 2005,gjendja e mirë Kam. "Mercedes Benz" Actros,Tip:42.41 me tp.reg. 02-330- FL, Vi i prodh. 2004, ngjyra e bardhë, gjendja e mirë Kam."Scania" Tip : R-124 , vi i prodh. 2002, me tp.reg. 02-760-IC,gjendja e mirë
4	d) Rrafshues tereni - greder	1	1	Autogreder: marka "Bomag", Tip:BG 160-3, vi i prodh.2004, gjendja e mirë

Pretendimi Nr.4
Është kërkuar:
a) Siguria e tenderit në shumën 30,000.00€ në vlefshmëri prej 120 ditë nga dt 12.05.2023

Komisioni i vlersimit të ofetave pranë AK ka bërë shkelje duke rekomanduar për kontratë një Operator Ekonomik i cili nuk posedon sigurimin e tenderit .Pretendimi i lartëcekur përbënë shkelje pasiqë në bazë të nenit 29 të RRUOP dhe nenit 57 të LPP : Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm . Në rastin tonë GOE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasiqë i njëjti së bashku me ofertën nuk ka dorëzuar edhe sigurim të tenderit .

PRISIG

POLICË SIGURIMI
INSURANCE POLICY

Sigurimi për Garanci
Guarantee Insurance

Seria | 1000053771

Për

KOMUNA E VUSHTRRISË

Titulli Title	Ndertimi i kanalizimeve sipas lot I deri ne III		
Emri i Ofertuesit Name of the Bidder	NNT BINI SH.P.K.	Prej From	12.05.2023
Adresa Address	Shkodër	Deri To	09.09.2023
Telefon Telephone	044178506	Shuma e sigurimit Insured sum	30.000.00 €
Numri i personal / biznesit Personal / business number	811318899	Primi Premium	225.00 €
Data e lëshimit Date of issue	10.05.2023	TVSH VAT	40.50 €
Numri i prokurimit Procurement number	VU644-23-2787-5-1-1	Totali për pagesë Total for payment	265.50 €
Lloji i kontratës Contract type	Garanci Oferte		

AUTORITETI KONTRAKTUES

Numri personal / biznesit Personal / business number	0000	Vendi City	VUSHTRRI
Adresa Address	VUSHTRRI	Telefon Telephone	038

Policë e sigurimit

DEKLAROJ se poshtë e bëra në këtë kërkesë për sigurim janë të plota dhe të vërteta dhe nëpërliqësi ka fshehje apo shtrembërim të faktave, and mësë dënë nga dëmshpërblimi në rast dëmi.
Policëmbajtësi deklaron se prejardhja e fondeve është në përputhje me Ligjin nr.03/L-196 si dhe paragrafin 6 të Rregullores No.X të Bankës Qëndrore të Kosovës.

Insurance Policy

I DECLARE that the allegations made in this insurance claim are complete and true and if there is concealment or distortion of the facts, I waive compensation in case of damage.
The policyholder declares that the origin of funds is in accordance with Law no.03 / L-196 as well as paragraph 6 of Regulation No. X of the Central Bank of Kosovo.

Agenti:

Floria Paparada

PRISIG

Kompania e Sigurimeve PRISIG SH.A / Numri unik identifikues: 810842532 / Tel: +383 (0) 38 221 000
Email: info@prisig-ks.com / www.prisig-ks.com / Adresat: Rr. Eduard Uz 173 Lagja Arbëria, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

PRISIG

POLICË SIGURIMI
INSURANCE POLICY

Lloji i Garancisë: Garanci Oferte

Seria

Për

KOMUNA E VUSHTRRISË

DUKE PASUR PARASYSH QË

NNT BINI SH.P.K.

ka marrë përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

Ndertimi i kanalizimeve sipas lot I deri ne III

si dhënë me numër e Prokurimit

VU644-23-2787-5-1-1

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit në numrin e dhënë të prokurimit;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar f.1 japim Operatorit Ekonomik këtë garanci.

PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi Garantues-dhe pëngjegjës-vdaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

30,000.00 €

Tridjetë Mijë e Euro

(shuma e garancisë në numra dhe në fjalë)

zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

a. Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht, se ai tenderues i ka dhënë informacione përmbajtësisë të gabuashme ose mashtruese Autoritetit Kontraktues;

b. Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të furnit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në Dosjenë të Tenderit;

c. Tenderuesi i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon:

• Që të depozitojë sigurimi e-ekzekutimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit;

• Të pranojë të gjitha kushtet që i paraqitjen nënshkrimit të kontratës në fjalë siç janë përcaktuar në Dosjen e Tenderit; apo

• Të lidhë kontratë që u përmbushët detyrave dhe kushteve të sëlëfituara në dosjen e tenderit.

Pagesa në shumën e limituar prej:

30,000.00 €

(shuma e garancisë)

siç janë thënë më lart, po pasur rezultat që të dëshmohet ose të japin arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës 12.05.2023 deri më 05.05.2025

Lëshuar në Prishtinë 10.05.2023

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

PRISIG

PRISHTINË

Kompania e Sigurimeve PRISIG Shoqëria me aksionarë njësi identifikuese: 810042032 / Tel: +383 (0) 38 221 333

Email: info@prisig-ks.com / www.prisig-ks.com / Adresa: Rr. Eduard Lir 173 Lagja Arbëria, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

----------perfundim i pretendimeve ankimore----------

Andaj arsyet dhe faktet e paraqitura më lartë, dhe për shkak që mos të dëmtohet interesi publik nga mungesa e marrjes së shërbimeve me kohë, dhe në anën tjetër që të ndalet dhe parandalohet dëmi serioz që është shkaktuar në drejtim të parashtruesit të ankesës duke ia mohuar të drejtën ligjore që të shpërblehet me kontratë pasi nuk ka asnjë bazë ligjore që të veprohet ndryshe, kërkojë që pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe provave të paraqitura OSHP ta aprovojë ankeseën tonë si të bazuar dhe lëndën ta kthej në rivlerësim.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional: **1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, (ndërtim i ulet), në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej Loto 1. 600,000.00 euro Loto 2. 700,000.00 euro Loto 3. 800,000.00 euro** **Në rast të Grupit të Op.Ek. lideri i grupit duhet të ketë jo më pak se 60% të vlerës së saktësuar si më lartë.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **1.Një listë te kontratave __ të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës t bashkëngjiten referencat ose certifikatat pë kryerje te punëve. Shënim Në rast se operator ekonomik dorëzon tender për 2 e me shume Lote, shuma më e lartë e kontratave që kërkohe për Lotet për të cilat konkurron duhet të përmbushet nga OE**
2.OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon Nje (1) inxhinier I diplomuar i ndertimtaris master i diplomuar (menaxher i projektit) drejtimi hiroteknikes , me me se paku tri vite përvojë pune pas diplomimit - Loto I, II, III dhe IV – Një (1) minimum bachellor i diplomuar i ndertimtaris ose master i diplomuar drejtimi hiroteknikes – me se paku dy vite përvojë pune pas diplomimit - për Loto I, II, III dhe IV - Një (1) minimum bachelor i diplomuar i gjodezis ose master, me se paku dy vite përvojë pune pas diplomimit - Loto I, II, III dhe IV.	**2.CV-a, Diploma Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.**

Kërkesa 3. Operatori ekonomik dueht të ketë stafë teknik në të cilët operatori ekonomik mund të thirret për realizimin e projektit dhe atë minimum tete (8) Puntorë teknik - ndhimës. Kjo kerkese vjen per të gjitha lotet I deri ne IV	**Dëshmia 3. Lista e punëtorëve teknik me të dhënat e tyre e nënshkruar dhe e vulosur, të cilë duhen dëshmuar me Kontratë të punës apo Parakontratë të punës të nënshkruar nga Punëdhënësi dhe Punëmarrësi si dhe e vulosur nga Punëdhënsi.**
Kërkesa 4. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit dhe atë minimum **a)2(dy) Eskevator-Bager me goma minimumi..9 ton** **b) 1 (Një) Eskevator Bager zingjir. Minimumi 10 ton.** **c) 2 (dy) Kamiona me aftësi bartëse minimum 10ton** **d) 1(nje) Kamiona me aftësi bartëse minimum 6ton** **dh) 1(nje) Rrafshues tereni greder** **e) 1(nje) Ngjeshse e zhavorit** **) 1(nje) Ngjeshse dheut** **1 (nje) Makineri për shpime horizontale 1 (nje)Kamion Cistern për ujë minimum 6m3**	**Dëshmia 4. Lista për makanizimin dhe pajisjet sipas Aneksit 7. e cila duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur dhe Një deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe evulosur me të cilen dëshmohet për makinerin dhe pajisjet në dispozicion të tenderuesit që ekzekuton shërbimet.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: NNT " **Bini "sh.p.k. – Podujevë**, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën **03.07.2023,** merr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet si e pabazë** Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e eliminuar, të subjektit në procedurë: NNT " **Bini "sh.p.k. – Podujevë, në procedurën e prokurimit me titull: " Ndërtimi i kanalizimeve , sipas Lot. 1 deri Lot. 3" , Nr.i prokurimit: VU644 – 23 – 2787 – 5-1-1 e Nr. i brendshëm: VU644-23-020-511**
2. **Vërtetohet si i bazuar** Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. **20.06.2023**

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejmë A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që në Lotin 1 " Ndërtimi i kanalizimeve sipas Lot. 1 " ta rekomandoi për dhënie të kontratës: **Grupin e OE.: " Urban O.P. "& " Amari GFC "sh.p.k. me seli në Mitrovicë, ndërsa, O.E.: NNT " Bini "sh.p.k.** (në tekstin e mëtejmë Ankuesin) ta renditë në mesin e O.E. të pasuksesshëm, bazuar në procedurën e zbatuar.

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi letër për tenderuesin e eliminuar për Ankuesin janë dërguar për publikim në platformën elektronike më dt. **20.06.2023,** bazuar në dispozitat e nenit 42 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se, duke vendosur si në **Vendimin e dt. 20.06.2023,** A.K. ka shkelur dispozitat e LPP-së , konkretisht: nenin 1 – Qëllimi , nenin 7 – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, nenin 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve dhe nenin 60 paragrafi 1 – Kriteret për dhënie të kontratës dhe nenin 69 – Aftësia teknike dhe / ose profesionale.

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë , për arsye se:

1. Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, neni 7 ka pasur për qëllim trajtimin e barabartë, pa diskrimininuar asnjë prej O.E. pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, Neni 33 paragrafi 1 (Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 59 (Ekzaminimi, vlerësimi dh krahasimi i tenderëve) lidhur me nenin 60 paragrafi 1 pika 1.1 **(tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët)** ka pasur për qëllim, që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të tenderëve, të vendosë për dhënie të kontratës O.E. me **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.** Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se **Vendimi i A.K. i dt. 20.06.2023** është marrë bazuar në kushtet , rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së, vendimi, sikurse ka vlerësuar A.K., është i mbështetur mbi baza ligjore e faktike, i pandikuar, që nuk diskriminon dhe që ka një transparencë të lartë të vendimmarrjes dhe po ashtu duke zbatuar kërkesat procedurale dhe qenësore të dispozitave të LPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues më tej vlerëson se të gjithë tenderët e tenderuesve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndërsa, i gjithë procesi ka qenë transparent, duke përfshirë këtu edhe të drejtën Ankuesit për të realizuar qasjen në dokumente të tenderit, konform nenit 10 dhe 11 të LPP-së.
3. Vendimi për ta rekomanduar për dhënie të kontratës : **OE.: " Urban O.P. "& " Amari GFC "sh.p.k. me seli në Mitrovicë** është marrë në mes tjerash edhe në zbatimin e nenit 59 të LPP-së, sepse një tender do të konsiderohet i përgjegjshëm dhe i pranueshëm vetëm nëse përmbushë kërkesat administrative, profesionale dhe minimalisht ato teknike dhe / ose profesionale të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.
4. Lidhur me pretendimin e Ankuesit se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka dorëzuar Certifikatën e TVSH-së , A.K. vlerëson këtë pretendim si të pasaktë sepse, sikurse është konstatuar padiskutueshëm, të dy anëtarët e Grupit të O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës kanë dorëzuar Certifikatën e TVSH-së duke i përmbushë kërkesat lidhur me Përshtatshmërinë Profesionale, sipas Nenit 7.1 lidhur me 7.2 të FTD-së , Kërkesat lidhur me Përshtatshmërinë Profesionale.
5. Pretendimi i Ankuesit se Grupi i O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka dorëzuar një Listë të projekteve sipas Aneksit 6 të Dosjes së tenderit, fillimisht sqarojmë se Aneksi 6 i Dosjes së Tenderit nuk përmban një kërkesë të tillë. Nga verifikimi i dëshmive të dorëzuara në Dosjen e Tenderit vërtetohet qartë se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës ka dorëzuar Listën e projekteve të përfunduara, dhe A.K. e ka vlerësuar si të rregullt pa ndonjë devijim të theksuar material marrë parasysh se O.E. bashkangjitur me Listën ka dorëzuar dhe Refrencën ose Raportin e Pranimit teknik të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues ku është ekzekutuar projekti dhe bazuar në faktin se dokumentet e dorëzuara pasqyrojnë dhe plotësojnë njëra tjetrën, Komisioni i vlerësimit i A.K. gjatë procesit të vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të dokumenteve nuk ka pasur ndonjë vërejtje, vështirësi apo paqartësi në vlerësimin e përmbushjes ose jo të kërkesave nga O.E. , të saktësuara në Dosjen e Tenderit, nenin 9.1 lidhur me 9.2 të FTD-së – Kërkesat lidhur me aftësitë teknike dhe / ose profesionale.
6. Lidhur me pretendimin e Ankuesit se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk i përmbushë kërkesat lidhur me posedimin e mekanizimit, respektivisht pajisjeve teknike në dispozicion për ekzekutimin e punimeve për të cilat ka tenderuar, A.K. konstaton se në Dosjen e Tenderit është dorëzuar e plotësuar dhe nënshkruar Lista sipas Aneksit 7 , ashtu sikurse është kërkuara në FTD, pika 4 dhe po ashtu bashkangjitur është dorëzuar dhe Deklarata me shkrim e nënshkruar dhe vulosur nga O.E për posedimin e pajisjeve të kërkuara – listuara si në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit, ndërsa dokumente apo dëshmi tjera plotësuese, sikurse pretendon Ankuesi, nuk janë kërkuar të dorëzohen. Andaj dhe ky pretendim ankimor i Ankuesit nuk qëndron sepse nuk është i bazuar dhe si i tillë është hedhur poshtë.
7. Lidhur me pretendimin ankimor të Ankuesit se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka pasur të drejtë të marrë pajisje me çera sipas ndonjë Marrëveshjeje pasi që , sikurse thekson Ankuesi, kjo mundësi nuk është e cekur në Dosjen e Tenderit dhe, bazuar në këtë O.e është i papërgjegjshëm, A.K. pasi vlerësoi këtë pretendim konstaton se pretendimi i Ankuesit është i pabazuar në dispozita ligjore. Sipas dispozitave të LPP-së O.E. i lejohet marrja me çera e pajisjeve teknike për ekzekutim të punimeve dhe A.K. nuk e ka ndaluar një mundësi të tillë.
8. Lidhur me pretendimin se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka dorëzuar Sigurinë e Tenderit, A.K. sqaron se një kërkesë e tillë nuk është saktësuar në nenin 13.1 të FTD-së pjesë e Dosjes së Tenderit, andaj dhe ky pretendim është hedhur poshtë si i pa saktë dhe jo i bazuar. Pretendimet tjera të Ankuesit , si mungesa e saktësimit të datës së përfundimit të projekteve në Listën e projekteve, sikurse ka vlerësuar A.K. paraqesin devijime të vogla, në kuadër të margjinave të lejuaa të LPP-së dhe të njejtat nuk paraqesin largim dhe kufizim thelbësorë nga Kërkesat e Dosjes së Tenderit për arsye se :
   - Nuk dallojnë esencialisht nga kushtet dhe dhe specifikimet e dosjes së tenderit;
   - Nuk fektojnë cilësinë ose ekzekutimin e kontratës;
   - Nuk kufizojnë të drejtat e A.K. dhe / ose obligimet e tenderuesit sipas kontratës dhe
   - Nuk shtrembëron konkurencën e tenderuesve, ofertimet e të cilëve janë në pajtueshmëri me rregullat e tenderit.
9. A.K. vlerëson se duke marrë këtë vendim ka pasur parasysh dhe mbrojtjen e parimit " VLERA PËR PARANË " , duke vlerësuar dhe respektuar fillimisht dispozitat ligjore lidhur me procesin e Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahasimit të tenderëve duke marrë për bazë dhe transparencën,

Trajtimin e barabartë të O.E. dhe jo-diskriminim në mes të O.E. duke përfunduar me zbatimin e parimit të " vlera për paranë " i cili në fakt është parim shumë i rëndësishëm për buxhetin e A.K. dhe të cilin sigurisht se A.K. e ka pasur në konsideratë.

10. Bazuar në të gjitha të cekurat si më lartë në këtë Vendim, A.K. vlerëson se pretendimet e Ankuesit janë të pabazuara, të pasakta dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. Përfundimisht, A.K. vlerëson se me rastin e marrjes së vendimit si ai i dt. 20.06.2023 për të përzgjedhur për rekomandim me dhënie të kontratës të Grupin e O.E.: " **Urban O.P. "& " Amari GFC "sh.p.k. me seli në Mitrovicë,** nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, me theks të veçantë neni 1 – Qëllimi, neni 7 – Barazia në trajtim/ Jo - diskriminimi sepse është rekomanduar O.E. me tender të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët ndërsa me asnjë provë nuk është vërtetuar se ndonjë O.E. është trajtuar Jo-barabar apo diskriminuese, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë në mes O.E., neni 51 – Njoftimi i kritereve të dhënies së kontratës dhe neni 59 parag.4 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K. përmes këtij Vendimi, janë të pabaza, jo të sakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë.

Nga sa u tha me lartë, e në pajtim me nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 të Rregullave për paraqitje të kërkesë për rishqyrtim, A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim Juridik :
Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur dispozitat e LPP-së apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni Ankesë pranë OSHP-së (Organit Shqyrtues për Prokurim Publik), në bazë të nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
K.R. nr. 020/2023 - datë 03/07/2023

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)

Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik

Albanez Tahiraj

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **NNT BINI SH.P.K.**

Sqarim hyrës

Me datën: 10.07.2023, OE "NNT BINI SH.P.K."- Podujevë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0475, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE "URBAN O.P & Amari GFC SH.P.K."- Mitrovicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i kanalizimeve sipas lot I deri ne III" me nr. të prokurimit: "VU644-23-2787-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E VUSHTRRISË. Në këtë ankesë OE " NNT BINI SH.P.K.", ka ngritur disa pretendime lidhur me shkeljet e disa neneve të LPP-së të cilat janë përfshirë në ankesë.

Pretendimi 1

Sipas OE ankues: *"Është kërkuar: - a) Certifikata e TVSH-s. Dëshmia e kërkuar: a) Kopja e certifikatës së TVSH-së . G.O.E. sipas dokumentacionit të dorëzuar nuk ka dorëzuar certifikatën e TVSH-së për partnerin e konzorciumit gjegjësisht për kompaninë AMARI GFC madje të njëjtën GOE nuk e ka dorëzuar pas kërkimit të sqarimeve nga ana e AK-së . Arsyeja e mosdorëzimit të certifikatës në fjalë është se OE Amari GFC nuk e ka poseduar atë certifikatë për të cilën OE ka aplikuar pas datës së hapjes së ofertave . Certifikata e TVSH për OE AMARI GFC nuk ka qenë në dosje as kur kemi marrur qasje në dokumente pranë AK por e njëjta na është dërguar më vonë në formë elektronike. Ky pretendim përbënë shkelje të dispozitave ligjore të LPP dhe RRUOP pasiqë AK ka shpallur fitues OE i cili në këtë rast nuk është i përgjegjshëm kurse kriter për dhënien e kontratës ka qenë OPERATORI I PËRGJEGJSHËM me çmimin më të ulët."*

Eksperti shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit tek fusha e kërkesave të përshtatshmërisë dhe ato profesionale është kërkuar që OE të dorëzojnë në ofertat e tyre edhe certifikatën e TVSH-së.

Përshtatshmëria profesionale: **1.Certifikata e Regjistrimit të Biznesit veprimtaria përkatëse 2.Nr. Fiskal 3.Certifikata e TVSH**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1..Certifikata e Regjistrimit të Biznesit veprimtaria përkatë kopje 2. Numri fiskal – kopje 3.Certifikata e TVSH –Kopje**

Sipas kërkesës në dosjen e tenderit, njëri nga anëtarët e konzorciumit GOE i rekomanduar përkatësisht OE -Amari GFC SH.P.K nuk e ka dorëzuar certifikatën për TVSH ashtu siç është kërkuar. Duke u bazuar në UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK nëse një OE i mungon certifikata e TVSH-së, AK ka të drejtë të kërkoj sqarim shtesë që OE t'a bashkëngjes këtë dokument i cili mungon. AK ka vepruar në të njëjtën mënyrë duke kërkuar nga Amari GFC SH.P.K t'a dërgoj certifikatën e TVSH-së. Mirëpo data e cila figuron në certifikatën e lëshuar për TVSH të dorëzuar në AK është data 05.06.2023, e cila tregon se OE për këtë certifikatë është regjistruar dhe është pajisur me të njëjtën vetëm pas kërkesës së AK, përkatësisht certifikata e kërkuar është nxjerrë 24 ditë kalendarike apo 16 ditë pune pas datës së fundit për dorëzimin e tenderëve dhe hapjes së tyre.

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E FINANCAVE – MINISTARSTVO ZA FINANSIJE – MINISTRY OF FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS – PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA – TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

ÇERTIFIKATË - DEKLARUES I TVSH

UVERENJE - OBVEZNIK ZA PDV

CERTIFICATE - VAT FILER

Numri Broj Number	330559809
Numri Fiscal Fiskalni Broj Fiscal Number	811906603
Emri i personit Ime osobe Person's Name	Amari GFC SH.P.K.
Adresa e Personit Adresa osobe Person's Address	.., ZHABAR I EPËRM MITROVICË KOSOVA
Data e Regjistrimit Datum Registracije Registration Date	05-06-2023
Data e Lëshimit Datum Izdavanja Date of Issuance	05-06-2023
Personi Përgjegjës Odgovorno Lice Responsible Person	

Kjo certifikatë është lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi vlerën e shtuar.
Ovaj certifikat izdat je od Poreske Administracije Kosova, shodno Zakona Br. 05/L-037 O Porezu na Dodanu Vrednost.
This certificate is issued by the Tax Administration of Kosovo, based on the Law Nr. 05/L-037 on Value Added Tax.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 72- Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë, pika 3 thuhet se-Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Çfarë do të thotë se çdo dokument i pranuar përmes kërkesës për sqarim por i cili datën e lëshimit e ka pas datës së skadimit për dorëzim të ofertave është në kundërshtim me dispozitat e nenit 72 pika.3. Eksperti shqyrtues vlerëson se në këtë rast është shkelur neni 72 i Ligjit për Prokurim Publik dhe pretendimi i ngritur është i bazuar.

Pretendimi 2

OE ankues pretendon se: *"a) 1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, (ndërtim i ulet), në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej Loto 1. 600,000.00 euro Loto 2. 700,000.00 euro Loto 3. 800,000.00 euro Në rast të Grupit të Op.Ek. lideri i grupit duhet të ketë jo më pak se 60% të vlerës së saktësuar si më lartë.: Dëshmia e kërkuar: a) Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve. Shënim Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 e me shume Lote, shuma më e lartë e kontratave që kërkohet për Lotet për të cilat konkurron duhet të përmbushet nga OE G.O.E. sipas dokumentacionit nuk e ka dorëzuar listën sipas kërkesës së AK-së pasiqë në listën e dorëzuar nga GOE i rekomanduar për kontratë , në shumicën e kontratave nuk figuron data e përfundimit siç është kërkuar nga ana e AK-së. Kjo përbënë shkelje sepse ANEKSI 6 është obligativ."*

Sa i përket pretendimit të ngritur nga OE ankues se GOE i rekomanduar nuk ka dorëzuar datat e përfundimit të projekteve, eksperti shqyrtues sqaron se këto janë devijime të vogla të cilat lejohen edhe me LPP, neni 52, pika 4 ku thuhet se - Autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii)përmban vetëmdevijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat,kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".

Të gjitha dëshmitë-referencat e dërguara nga OE e rekomanduar sipas kërkesës në Dosje të Tenderit kanë datën e fillimit dhe të përfundimit të projektit gjithashtu edhe të dhënat e tjera të cilat janë kërkuar nga AK.

Si dëshmi mund të shihet njëra nga referencat e mëposhtme e cila e ka edhe datën e përfundimit të projektit, ashtu si edhe dëshmitë e tjera. Andaj vlerësojmë se kjo nuk mund përdoret si arsye për eliminim të OE.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

E përpiluar me daten **28.03.2017** ndërmjet palëve kontraktuese:

Komunës se Lipjanit të cilën e përfaqëson, **Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan z. Adem Duriqi** në njërën anë (në tekstin e mëtejmë) Autoriteti Kontraktues dhe

Emri i Kontraktuesit Operatori ekonomik **NNSH "Urban"**-rruga "Selaniku" pa.nr Mitrovicë, të cilin e përfaqëson **Ibish Carani, Drejtor,** në vazhdim përdoret (shkurtesa) Kontraktuesi, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punët në vijim:

"Mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara në Komunën e Lipjanit" me numër identifikues: 613 017 004 521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e punëve në vijim:

Mirëmbajtja e rrugëve te asfaltuara, grryerja dhe largimi i shtresave të asfaltit në vendet e dëmtuar deri në deponi të caktuara në vendin ku e cakton menagjeri i kontratës, furnizimi dhe lyerja me bitum e shtresës ku bëhet lyerja e asfaltit për lidhjen me shtresen e re, furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gelqeror 0-31.5mm, punimi i shtresës se asfaltit 0,11-16mm me ateste Marshall, furnizimi, transporti dhe vendosja e skajoreve në bazën prej betoni të thjeshtë C20 me dim 18x24 cm me ramje 15 shkallë, furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit te thyer gelqeror 0-63mm, furnizimi, transporti, shtruarja dhe ngjeshja e zhavorrit 0-8mm ne trashesi t=4cm nën elementet prej betoni (kubzave), të gjitha të specifikuara në paramase të dosjes së tenderit.

Riparimi përafersisht 12500 m2 të rrugëve

Me fillimin e punëve do hapet ditari i punës dhe terren duhet të jetë çdo herë inxhinieri cili do ta nënshkruan ditarin së bashku me menaxherin e caktuar nga autoriteti kontraktues.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit nga përfaqsuesi i Autoritetit kontraktues dhe nga përfaqësuesi i ofruesit të punëve, gjegjësisht nga **data 28.03.2017** dhe përfundon në datën **më 28.03.2020.**

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të punëve do të jetë që nga nënshkrimi i kontratës deri me 28.03.2020.

2.2 Vendi i kryerjes së punëve do të jetë Rrugët e asfaltuara të Komunës së Lipjanit.

Pretendim 3

"Është kërkuar: a) Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit dhe atë minimum a)2(dy) Eskevator-Bager me goma minimumi..9 ton b) 1 (Një) Eskevator Bager zingjir. Minimumi 10 ton. c) 2 (dy) Kamiona me aftësi bartëse minimum 10ton d) 1(nje) Kamiona me aftësi bartëse minimum 6ton dh) 1(nje) Rrafshues tereni greder e) 1(nje) Ngjeshse e zhavorit) 1(nje) Ngjeshse dheut 1 (nje) Makineri për shpime horizontale 1 (nje)Kamion Cistern për ujë minimum 6m3 Dëshmia e kërkuar: a) Dëshmia 4. Lista për makanizimin dhe paisjet sipas Aneksit 7. e cila duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur dhe Një deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe evulosur me të cilen dëshmohet për makinerin dhe paisjet në dispozicion të tenderuesit që ekzekuton shërbimet. G.O.E. ka ofruar listën e makinerisë sipas ANEKSIT 7 mirëpo tek pika c) 2 (dy) Kamiona me aftësi bartëse minimum 10ton ,GOE i rekomanduar për kontratë ka ofruar

tjetër makineri (jo atë që është kërkuar në DT) . Ndryshimi i kritereve përbënë ndryshim thelbësor andaj rekomandimi për dhënie të kontratës për GOE në fjalë të cilët janë të papërgjegjshëm përbënë shkelje të dispozitave të LPP dhe RRUOP. b) Në FTD nuk ceket se lejohet marrëveshje për marrje të mjeteve me qira andaj ne si OE konsiderojmë se GOE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm pasi që nuk e plotëson këtë kërkesë të AK-së meqenëse një pjesë të makinerisë e ka të marrura me qira."

Sipas mendimit të ekspertit, OE i rekomanduar ka ofruar listën e pajisjeve ashtu siç janë kërkuar përmes Ankesi 7 në Dosjen e Tenderit. Bazuar në këto dëshmi OE i rekomanduar ka plotësuar këto kërkesa duke i ofruar dëshmitë ashtu siç janë kërkuar, ndërsa sa i përket emërtimit të pajisjeve nuk është relevante se çfarë emërtimi është përdorur në listë përderisa pajisjet e ofruar janë të njëjtat me pajisjet e kërkuara nga AK në Dosjen e Tenderit. Andaj ne konsiderojmë se ky pretendim i ngritur nga OE ankues është i pabazuar.

Titulli : Ndërtimi i kanalizimeve sipas Lot I deri në III

Aneksi 7. **PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM**

Mekanizimi dhe pajisjet e paraqitura ne Kërkesat mbi mundësitë teknikedhe/ose profesionale Operatorët Ekonomik, munden që në listë të shtojnë edhe mekanizim dhe pajisje treja shtesë si në aspektin e llojit ashtu edhe të sasisë. Lista duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga operatori ekonomik.

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e Kërkuar	Sasia e ofruar	Të dhenat për pajisjet (viti I prodhimit ,gjendja e pajisjes , kamiona rexh. I tarpave, mekanizimi , dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim ,foto etj
1	a) Eskavator –bager me goma min.9 t.	2	2	1.Bager "Liebher"Tip:A-902 Litronok,ngjyra e verdhë-bardhë,v.i prodh.1997,nr.serik:3564071,gjendja e mirë 2.Bager "Liebher" Tip: A-308,v.i prodh.1999,nr.i shasisë:3740579,gjendja e mirë
2	b) Eskavator – bager në zinxhir min.10 t.	1	2	Esk. Ma :"Volvo"; Tip: EC210 BLC Pesha: 22.400 kg.- Viti i prodh. 2003, gjendja e mire Eskavator "Liebher " Tip. R 9148 HDSL Pesha : 24.000 kg.Viti- 2005, gjendja e mire
3	c) Kamiona me kapacitet minimum 10 m³,kiper	2	4	Kam "Man" kipper 27.463 6x6 – me tg.regj.02 -576 –AF, V.i prodh..1998, gjendja e mire Kam."Man" me tg.regj.02-629-FI ; Viti i prodh. 2005,gjendja e mirë Kam. "Mercedes Benz" Actros,Tip:41.41; me tg.regj. 02-392- FL, V.i prodh. 2004, ngjyra e bardhë, gjendja e mire Kam."Scania" Tip : R-124 ; v.i prodh. 2000; me tg.regj. 02-760-EC,gjendja e mirë
4	d) Rrafshues tereni - greder	1	1	Autogreder: marka "Bomag", Tip:BG 160-T, v.i prodh.2004, gjendja e mirë

Sa i përket pretendimit për pajisjet me qera, në dosjen e tenderit tek kërkesat për makineri dhe pajisje është kërkuar që OE të kenë në ''dispozicion'' makineritë dhe pajisjet e nevojshme.

Shih dëshminë më poshtë:

Kërkesa 4. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit dhe atë minimum a)2(dy) Eskevator-Bager me goma minimumi..9 ton **b) 1 (Një) Eskevator Bager zingjir. Minimumi 10 ton.** **c) 2 (dy) Kamiona me aftësi bartëse minimum 10ton** **d) 1(nje) Kamiona me aftësi bartëse minimum 6ton** **dh) 1(nje) Rrafshues tereni greder** **e) 1(nje) Ngjeshse e zhavorit** **) 1(nje) Ngjeshse dheut** **1 (nje) Makineri për shpime horizontale 1 (nje)Kamion Cistern për ujë minimum 6m3**	**Dëshmia 4. Lista për makanizimin dhe paisjet sipas Aneksit 7. e cila duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur dhe Një deklaratë me shkrim e nënshkruar dhe evulosur me të cilen dëshmohet për makinerin dhe paisjet në dispozicion të tenderuesit që ekzekuton shërbimet.**

Sipas kërkesave në Dosje të Tenderit nuk është kërkuar që ato makineri apo pajisje të jenë në pronësi të OE, por të jenë në dispozicion të OE për realizimin e kontratës. Andaj vlerësojmë se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Pretendimi 4

Pretendimi Nr.4, OE ankues pretendon se: "*Është kërkuar: a) Siguria e tenderit në shumën 30,000.00€ në vlefshmëri prej 120 ditë nga dt 12.05.2023 Komisioni i vlersimit të ofetave pranë AK ka bërë shkelje duke rekomanduar për kontratë një Operator Ekonomik i cili nuk posedon sigurimin e tenderit .Pretendimi i lartëcekur përbënë shkelje pasiqë në bazë të nenit 29 të RRUOP dhe nenit 57 të LPP : Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm . Në rastin tonë GOE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasiqë i njëjti së bashku me ofertën nuk ka dorëzuar edhe sigurim të tenderit.*"

Mendimi i ekspertit shqyrtues është se në Dosjen e Tenderit nuk është kërkuar që OE të dorëzojnë sigurimin e tenderit gjatë dërgimit të ofertave andaj duke u bazuar në këto dëshmi që mund të shihen edhe më poshtë, një pretendim i tillë i ngritur nga OE ankues është i pabazuar.

Siguria e tenderit	13.1	A është e nevojshme siguria e tenderit: Po ☐ Jo ☒

Duke u bazuar në dëshmitë dhe sqarimet e përmendura më lartë, rezulton se pretendimet e ngritura nga OE ankues janë pjesërisht të bazuara.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E VUSHTRRISË**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **NNT BINI SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
PRISHTINË/A
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
REPUBLIKA KOSOVA

Agnese Ibrahimi

Ibrahimi